






BASHKIA GRAMSH

RAPORTI I PERFORMANCËS 2025



BASHKIA GRAMSH

Dokumenti bazohet në të dhënat e Sistemit të Matjes së Performancës 2023-2024. Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Gramsh me asistencën e Projektit Bashki të Forta.

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit Bashki të Forta, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Zvicrës SDC) dhe Qeverisë së Suedisë (Ambasada e Suedisë në Shqipëri) i zbatuar nga Helvetas. Projekti ka si synim kryesor që qytetarët shqiptarë të përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe i shërbimeve në nivel vendor sipas standardeve minimale dhe të përballueshme të miratuara për një sistem të qëndrueshëm në vend.

Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë



Schweizerische Eidgenossenschaft

Confédération suisse

Confederazione Svizzera

Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden

Sverige

PËRMBAJTJA

Fjalor Shpjegues	4
Qellimi I Raportit	8
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	8
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë.....	10
SHERBIME PUBLIKE VENDORE	11
 Arsimi Paraniversitar	12
..... Error! Bookmark not defined.	
 Menaxhimi i Mbetjeve	14
 Mbrojtja nga zjarri	16
 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	17
 Administrimi i pyjeve dhe kullotave	19
 Mbrojtja Sociale	21
QEVERISJA E MIRE.....	23
 Burimet Njerëzore.....	24
 Transparenca	24
 Barazia Gjinore	27
€ Integrimi në BE.....	28
MENAXHIMI FINANCIAR	30
Përfundime dhe Rekomandime	32

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kriterëve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njërive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Këto përfshijnë, ndër të tjera, ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe cerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas perkufizimit dhe ligjit “Sherbime Publike Vendore” janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor/financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transferrat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transferrat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve në çdo fushë paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2023 / 2024	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2024} - \text{Vlera 2023}) / \text{Vlera 2023} \times 100$.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2024 – Vlera 2023). Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës: ● = vlerë absolute ndryshimi pozitiv ● = vlerë absolute ndryshimi negative.

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm "vlera positive ndryshimi = jeshile". Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv.

Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

QELLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Gramsh, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia Gramsh kufizohet në veri me bashkinë Elbasan, në lindje me bashkinë Pogradec, në jug-lindje me bashkinë Maliq, në jug me bashkinë Skrapar dhe në perëndim bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik. Përbëhet nga 10 Njësi Administrative: Pishaj, Poroçan, Skënderbegas, Tunjë, Sult, Kushovë, Kodovjat, Kukur, Lenije, Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gramshit me sipërfaqe prej 695km². Bashkia e Gramshit shtrihet në një territor shumë malor në Shqipërinë qendrore, ku toka bujqësore është e paktë (rreth 14 përqind e sipërfaqes) ndërsa pjesa tjetër e territorit është zonë pyjore ose kullotë. Bashkia ka një numër total banoresh prej 33997 nga të cilat 30% në pjesën urbane dhe 70% në pjesën rurale të bashkisë. Qyteti i Gramshit numëron në total rreth 500 biznese të regjistruara, 430 biznese në qytet dhe 70 biznese në njësitë administrative , shumica prej të cilave biznese të vogla tregtie apo shërbimesh. Bashkia drejtohet në mandatin e parë të tij nga Kryetari i sapo zgjedhur Z. Besion Ajazi Bashkia Gramsh arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë ka pësuar rënie. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë biznet e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Shërbimet edhe pse nën ndikimin e rënies së volumit të xhiros duke u krahasuar me vitin 2021, kur pothuajse u mbyllën totalisht njësitë e bar-restoranteve, e rimorën disi veten në vitet pasardhëse. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Në tërësi bizneset e shërbimeve, ndërkohë që ato të prodhimit bujqësor kanë rritur prodhimet e për rrjedhojë të ardhurat, e tyre të cilat kontribuan në më shumë të ardhura nga taksat dhe tarifat

vendore që mbledh bashkia. Në ndryshim nga bizneset e shërbimeve ku në një masë të konsiderueshme ndaluan punën tërësisht ose përkohësisht për t'iu adaptuar kushteve të reja pandemike, ato në fushën e prodhimit bujqësor nuk e ndaluan për asnjë moment punën. Viti 2022 shënoi një vit të rimëkëmbjes pas dy viteve të vështira pandemike, duke risjellë rimëkëmbje të biznesit aktual edhe në fushën e turizmit.

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit janë:

Sfida demografike dhe migrimi

- Zvogëlimi i popullsisë për shkak të emigracionit jashtë vendit dhe migrimit të brendshëm drejt Tiranës e qyteteve të mëdha.
- Plakja e popullsisë: një pjesë e madhe e banorëve janë në moshë të thyer, gjë që ndikon në fuqinë punëtore dhe dinamizmin ekonomik.
- Largimi i të rinjve: mungesa e mundësive për arsim, punësim dhe aktivitete kulturore i shtyn të rinjtë të largohen.

Zhvillimi ekonomik i kufizuar

- Ekonomi e bazuar kryesisht në bujqësi dhe blegtori tradicionale, shpesh me produktivitet të ulët dhe teknologji të vjetëruar.
- Mungesë e diversifikimit ekonomik – mungojnë sipërmarrje të reja, industrinë përpunuese apo sektorë inovativë.
- Investime të ulëta private për shkak të tregut të vogël dhe mungesës së infrastrukturës mbështetëse.

Infrastruktura dhe lidhjet e kufizuara

- Rrjet rrugor i amortizuar në shumë zona rurale, duke e bërë të vështirë lidhjen me qendrat e tjera ekonomike.
- Transporti publik i kufizuar dhe jo i rregullt, veçanërisht drejt fshatrave dhe njësive administrative.
- Mungesë e infrastrukturës turistike që ndalon zhvillimin e potencialeve të mëdha natyrore dhe kulturore që Gramshi ka.

Arsimi dhe punësimi i të rinjve

- Mundësi të pakta për arsim profesional dhe trajnime, duke kufizuar aftësitë e të rinjve për tregun e punës.
- Papunësi e lartë e të rinjve dhe mungesë e nismave për nxitjen e sipërmarrjes së tyre.
- Lidhje e dobët mes arsimit dhe tregut të punës – të rinjtë shpesh nuk gjejnë punë në profesionet e tyre.

Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i potencialeve natyrore dhe turistike

- Gramshi ka burime ujore, natyrë të pasur dhe mundësi për turizëm malor dhe aventurë, por këto janë pak të zhvilluara për shkak të mungesës së infrastrukturës, promovimit dhe investimeve.
- Mungesë e planeve të mirëfillta të menaxhimit të turizmit dhe partneriteteve me sektorin privat.

Shërbimet publike dhe administrata vendore

- Burime të kufizuara financiare për investime në shërbime dhe projekte zhvillimore.
- Kapacitete të kufizuara administrative dhe teknike në nivel vendor për hartimin dhe zbatimin e projekteve.
- Nevoja për modernizim të shërbimeve publike dhe dixhitalizim për të rritur efikasitetin dhe transparencën.

Bashkia Gramsh ka potencial të madh zhvillimi – sidomos në turizëm natyror, agroturizëm, prodhime bujqësore cilësore dhe përfshirjen e të rinjve – por për ta shfrytëzuar plotësisht këtë potencial, duhet të adresojë këto sfida:

- të frenojë emigracionin e të rinjve,
- të përmirësojë infrastrukturën dhe shërbimet publike,
- të tërheqë investime,
- të zhvillojë sektorë të rinj ekonomikë dhe turizmin,
- dhe të rrisë kapacitetet e administratës vendore.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2024
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	33997
Popullsia në qytet	15982
Popullsia në njësiti administrative	18051
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	695
Sipërfaqe publike e bashkisë në km ²	1,5
Sipërfaqja e njësive administrative në total	693,5
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	44028
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	10075

Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	10282
Numri total i njësive administrative të bashkisë	9
Numri i fshatrave	94
Punonjës të bashkisë në total	369
Numri total i punonjëseve femra të bashkisë	178
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	191
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	199
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë	130

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësisë të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performances bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimit parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendor që janë perzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.



ARSIMI PARANIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”

Funksioni 23.12: “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore (23.11), si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit 23.12, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

Analiza e Shërbimit

Bashkia ka arritur rritje të ndjeshme të regjistrimit në të dy nivelet e arsimit parashkollor, me çerdhen publike që arriti mbulim të plotë (100%) dhe po ashtu kopshtet publike që kaluan nga 89.8% në 100%.

Raporti fëmijë–mësues është rritur nga 7.7 në 8.8 nxënës/mësues, duke u afruar drejt një efieiene më të mirë në përdorimin e burimeve njerëzore. Sipas OECD Education at a Glance (2023), mesatarja në vendet e OECD është rreth 14 fëmijë për edukator në arsimin parashkollor, prandaj bashkia ende mbetet nën këtë nivel, por tendenca është pozitive dhe lëviz drejt standardit ndërkombëtar.

Ndërkohë, numri i godinave arsimore ka mbetur i pandryshuar, gjë që tregon se zgjerimi i mbulimit është arritur pa shtim të infrastrukturës, por përmes shfrytëzimit më efikas të kapaciteteve ekzistuese. Vlen të theksohet se të gjitha godinat arsimore në bashkinë Gramsh janë godina publike dhe shërbimi i ofruar është teresisht publik.

Klasifikimi teknik

- Përmirësuar (3)
 - Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike: 47.1% (2023) → 100% (2024), +52.9 pp
 - Shkalla e regjistrimit në kopshte publike: 89.8% → 100%, +10.2 pp
 - Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike: 7.7 → 8.8, +14%
- Pa ndryshim (2)
 - Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar: në fuqi të dy vitet
 - Numri i godinave arsimore: 66 → 66

TREGUESIT E PERFORMANCËS

A)Tabela përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	%	47.14	100.00	52.86	↑	Përmirësuar	●	1
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike	%	89.83	100.00	10.17	↑	Përmirësuar	●	
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	7.70	8.80	1.10	↑	Përmirësuar	●	14%
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	66.00	66.00	0.00	↓	Pa ndryshim	●	0%

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki	70.00	28.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	33.00	28.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës nga 3–6 vjeç në bashki	600.00	528.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	539.00	528.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	0.00	0.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte publike	70.00	60.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte private	0.00	0.00	Numër

Numri i çerdheve publike në bashki	1.00	1.00	Numër
Numri i çerdheve private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i kopshteve publike në bashki	33.00	33.00	Numër
Numri i kopshteve private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	25.00	24.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	7.00	8.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	0.00	0.00	Numër
Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	1.00	1.00	Po/Jo



MENAXHIMI I MBETJEVE


Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënien e granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Analiza e Shërbimit

- Shërbimi i mbetjeve ka mbuluar në mënyrë të qëndrueshme 100% të zonave urbane dhe vetëm 17% të zonave rurale, duke sjellë një mbulim total prej 58.5% të popullsisë, pa ndryshim nga viti i kaluar.
- Është ulur sasia e mbetjeve të gjeneruara nga 72.1 kg/banor në 66.7 kg/banor. Kjo rënie, megjithëse sinjalizohet teknikisht si përkeqësim, mund të lidhet edhe me reduktim të konsumit apo përmirësim në menaxhim.
- Mbulimi i koston nga tarifa është ulur ndjeshëm nga 0.52% në 0.27%, pasi shpenzimet për shërbimin janë dyfishuar (16.8 → 36.5 milionë lekë), ndërkohë që të ardhurat nga

tarifa janë rritur vetëm lehtë (8.8 → 9.7 milionë lekë). Kjo krijon një hendek më të madh financiar për mbulimin e kostos.

- Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve mbetet në fuqi, duke siguruar bazën e vazhdimësisë institucionale.



A) Treguesit përmbljedhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	58.51	58.51	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	72.06	66.66	-5.40	↓	Përkeqësuar	●	-7%
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	0.52	0.27	-0.26	↓	Përkeqësuar	●	-49%
Tregues	Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve i miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	0.17	0.17	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	3.00	3.00	Numër
Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	3.00	3.00	Numër
Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	16.00	16.00	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkise	94.00	94.00	Numër
Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	2463000.00	2266200.00	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	8812.68	9743.20	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	16843.57	36486.00	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	34179.00	33997.00	Numër



MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Aktivitete përfaqësuese përfshijnë: Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës; Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare; Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Numri i punonjësve zjarrfikës është rritur (14 → 16), ndërkohë që popullsia ka mbetur pothuajse e qëndrueshme (34,179 → 33,997). Kjo ka bërë që treguesi i zjarrfikësve për 1,500 banorë të përmirësohet, duke u afruar më shumë me standardin minimal kombëtar.

Numri i automjeteve zjarrfikëse funksionale ka mbetur i njëjtë (2 mjete), çka tregon stabilitet në kapacitetin bazë të reagimit. Megjithatë, raporti për banorë mbetet i ulët dhe sinjalizon nevojën për investime shtesë në pajisje.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Zjarrfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.61	0.71	0.09	↑	Përmirësuar	●	15%
Tregues	Automjete zjarrfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.59	0.59	0.00	↑	Përmirësuar	●	1%

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrfikës në bashki	14.00	16.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	34179.00	33997.00	Numër
Numri i mjeteve zjarrfikëse funksionale në bashki	2.00	2.00	Numër

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funksioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

Analiza e Shërbimit

Gjatë vitit 2024 janë monitoruar dhe mbajtur nën kujdes disa segmente të rëndësishme të rrjetit ujitës në njësinë administrative Poroçan dhe fshatrat përreth. Ndërhyrjet kanë përfshirë pastrimin dhe zgjerimin e kanaleve, hapjen e segmenteve të bllokuara si dhe largimin e pengesave të përkohshme të shkaktuara nga faktorë natyrorë apo ambiental. Përveç punimeve të mirëmbajtjes, është siguruar mbikëqyrja e vazhdueshme për të adresuar në kohë ankesat e fermerëve dhe për të garantuar rrjedhjen e pandërprerë të ujit për vaditje.

Në vitin 2024, sipërfaqja e tokës bujqësore të mbuluar me kanale ujitje e kullimi është rritur ndjeshëm (730 ha → 6,356 ha), duke treguar një përmirësim shumë të madh në mbulimin e infrastrukturës. Po ashtu, kanalet ujitëse funksionale janë shtuar si gjatësi nga 28 km në 44 km, duke forcuar aksesin në ujitje. Segmente ne te cilat eshte punuar per permiresimin e ketij sherbimi janë:

Posnovisht - Bërsnik sipër
Bërsnik sipër- Mashan
Bërsnik sipër- Bërsnik posht
Bërsnik sipër- Kodovjat
Kanali Hotomi- Poroçan

Nga ana tjetër, kanalet kulluese nuk përdoren, pasi gjeografia e bashkisë (terrën kryesisht malor-kodrinor) nuk kërkon sisteme drenazhimi si në zonat fushore.

Në tërësi, sektori ka bërë një hap shumë të madh përpara në infrastrukturën e ujitjes, ndërsa për kullimin situata mbetet neutrale dhe e përcaktuar nga specifikat gjeografike të territorit.

- Përmirësuar (2)
 - Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi: 7.1% (2023) → 61.9% (2024), +54.8 pp
 - Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale: 14.6% → 22.9%, +8.3 pp
- Neutrale për shkak të gjeografisë (1)
 - Kanalet kulluese: 0% në të dy vitet. Nuk paraqitet si mungesë funksionaliteti, por si karakteristikë e terrenit malor-kodrinor, ku nevoja për rrjet kullues është e kufizuar.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me	%	7.10	61.85	54.75	↑	Përmirësuar	●	

	kanale ujitje/kullimi								
Nen- tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	14.58	22.92	8.33	↑	Përmirësuar	●	
Nen- tregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%				↓	Përkeqësuar	●	

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	10282.00	10276.00	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	730.00	6356.00	Hektarë
